

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr I i prokurimit	KRURGJA-24-10434-5-2-1
-------------------	-------------------------------

Sa i përket tenderit për **Nderrimi gypit furnizues nga stacioni i pompave Pataqan i ulet deri te rezervuari Pataqan i Eperm L= 2700m**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Bajram Ha. Gashi B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com

(Adresa)

Suhareke

(Vendi)

(Kodi postar)

044/356164

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Bajram Gashi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com

(Adresa elektronike)

18.12.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)



(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontrate 08.10.2024
Hapja e ofertave 31.10.2024.
Njoftimi mbi vendimin e AK-se 03.12.2024
Kërkesa për ri shqyrtim 09.12.2024
Vendimi i AK-se refuzimi i kërkeses 10.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e ofertave 31.10.2024.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?



Po

Jo

Operatori Ekonomik "Bajram Ha. Gashi" BI, me datën 09.12.2024, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, ka prezantuar prova dhe dëshmi me te cilat eshte konfirmuar pa pergjegjeshmeria e OE te propozuar për kontrate dhe se AK, pavaresisht ketije fakti perseri ka lene ne fuqi vendimin saje dhe ka refuzuar kerkesen tone si te pa baze me vendim e datës 10.12.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr 04/L-042, i amendamentuar.

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave.
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.
- Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarreshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Për këtë procedurë te prokurimit, operatori ekonomik ankues "Bajram Ha Gashi" BI, me daten 03.12.2024, ka pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – Formularin B58, ku është rekomanduar për dhënie te kontratës grupi i operatoreve ekonomik "Fidani L" shpk & Fidani Beton" shpk.

Operatori Ekonomik ankues konsideron se është rekomanduar për dhënie te kontratës grup i operartoreve te pa pergjegjeshem dhe kundër ketije propozimi me datën, 09.12.2024 ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim ka prezantua prova dhe dëshmi për veprime kundërligjore por pavaresisht kësaj AK, me datën 10.12.2024, nxjerr vendim dhe refuzon kerkesen tone si te pa bazuar, prandaj bazuar ne nenin 109 te LPP-se, paraqesim kundershtrimet tona me këtë Ankese:



Pretendimi ankimore 1.

Autoriteti Kontraktues – KRU Gjakova sha, ne dosje te tenderit, gjegjesisht ne piken 2.1, tek kerkesat e kapaciteit teknik dhe profesional ka kerkuar:

- *“Një ing i diplomuar apo master i ndertimtarise me pervoje pune me nin 5 vite pas diplomimit – konstruktiv apo hidroteknik i cili do te jete edhe menaxher i ketije projekt”.*

Grupi i Operatoreve Ekonomik te propozuar për dhenien e kontratës ne oferte ka prezantuar listën e stafit profesional dhe ne cilesine e ing te ndertimtarise – Hidroteknikë, ka prezantuar me z. Dukagjin Rudi. Si dëshmi dikumentare ndaj ing te hidroteknikes është prezantuar kopja e diplomes, CV dhe leter referencat, por nuk është **prezantuar vendim apo dëshmi tjetër për emërim apo caktim te menaxherit te projektit ashtu siç është kerkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate**, si rrjedhoje dëshmitë e prezantuara ne oferte ndaj inxhinierit te prezantuar nuk e plotesojne kerkesen kualifikuese dhe se AK – KRU Gjakova sha, rrjedhimisht komisioni vlereues i ofertave ka qene dashur ta eliminoi te njejtën oferte si te pa pergjegjeshme. AK – ne vendimin e datës 10.12.2024, mungesen e vendimit apo percaktimit te menaxherit e ka lene si te nenkuptuar dhe për këtë qështje nuk e ka argumentuar ligjerisht me dispozita ligjore. Me nenin 59.4, te LPP-se kjarte percaktohet qe: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të pergjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kerkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Në dosje te tendeit tek draft kontrata është e percaktuar qarte roli i menaxherit te projektit dhe menyra e percaktimit te tij, AK pavaresisht kesaje, rekomandon për dhënie OE te pa pergjegjeshem dhe favorizon kompaninë e rekomanduar për dhënie gjegjesisht diskriminon kompaninë tone.

Pretendimi ankimore 2.

Ngjashëm është vepruar edhe me z. Drilon Sallahu, i cili ne liste është prezantuar si gjeometer.

Ne piken 2.2, te kerkesave te kapacitetit teknik dhe profesional, është kerkuar:

“Një gjeometer me minimum 1 vit pervoje pune”.

Për te njejten pike ne deshmine dokumentare është kerkuar:

“Kontrata e punes ose marreveshja e bashkepunimit nese është angazhuar vetëm për këtë projekt, diploma dhe CV – Referenca apo kontrata për te deshmuar pervojen e punes...”

Grupi i Operatoreve Ekonomik, te propozuar për dhenie te kontratës ne oferte nuk kane prezantuar me Gjeometer, përkatësisht është prezantuar licenca e Teknikut te Gjeodezisë. Pikerisht ne licencen e prezantuar ne oferte pershkruhet qe Tekniku Gjeodet, sipas UA nr. 13/2019, neni 5 ka te drejte te ofroje vetëm këto sherbime profesionale: ndarjen e parcelave, bashkimin e parcelave dhe piketimin e parcelave.

Prove: Licenca e prezantuar ne ofertën e OE te propozuar.



TEKNIK GJEODET I LICENCUAR

DRILON SHLLAKU

Numri i licencës: 7

Data e dhënies së Licencës / Datum izdavanja Licence: **03.03.2020**
Afati i skadimit të Licencës / Datum okončavanja Licence: **03.03.2025**

Shënim: Tekniku gjeodet i licencuar sipas UA Nr.13/2019 Neni 5 ka të drejtë të ofrojë vetëm këto shërbime profesionale: ndarja e parcelave, bashkimi i parcelave dhe piketimi i parcelave

Zabeleška: Licencirani tehničar geodeta shodno AU Nr.13/2019, Član 5, ima pravo da pruža samo sledeće usluge: podela parcela, spajanje parcela i označavanje parcela

Drejtor ekzekutiv

Avni AHMETI



Marrë parasysh projektin kryesore te publikuar nga KRU Gjakova sha, për “Ndertimin e gypit furnizues nga stacioni i pompave, Pataqan i ulet deri tek Rezervuari Pataqan i Eperm, nuk ka te beje me ndarje te parcellave, bashkim te tyre apo edhe piketim te parcellave.

Për projektin ne fjale roli i gjeodetit është kyc dhe grupi i operatoreve ekonomik te propozuar për dhënie te kontratës do duhej te prezantonte Gjeodet te licencuar dhe jo teknik te gjeodezise, ashtu siç është kerkuar ne Dosje te Tenderit, meçe sipas projektit detaj te AK-KRU Gjakova sha, paramases dhe paralogarise, detyrimisht, për ekzekutimin e projektit ne fjale duhet te realizohen matjet kadastrale si me poshte:

- Percaktimi i kufirit te parcelave nga te dhenat zyrtare
- Identifikimi i njësive kadastrale
- Udheheqje e puneve gjeodezike
- Piketeimi i te dhenave nga planet urbanistike
- Konsulta profesionale
- Matje gjeodezike për barazim te rrjeteve shteterore duke perfshire rrjetin e nivelimit dhe matjer gravimetrike etj.

Për këtë qeshtje AK , ne vendimin e saj ndaj kerkeses sonë për ri shqyrtim potencon se termi Gjeometer nenkupton teknikun e gjeodezisë. Ligjerisht dhe logjikisht tenimi i tille i referohet objektit dhe jo subjetit perkatesiht paisjes gjeodezike, dhe nenkuptimi i AK-se, për teknik te gjedozise qarte është arsyetuar ne kerkesen për ri shqyrtim te datës 09.12.2024, ku ne si OE kemi prezantua ne aspekt ligjore mundesin e veprimeve te lejuara dhe certifikimin e gjeometrit te prezantuar. Kerkesa kualifikuese është e kjarete është kerkuar gjeometer me pervoje pune se paku 1 vit pas diplomimit. Shkollimi i mesem perkatësisht titulli “Teknik Gjeodet i Licencuar” nuk është i barazvlefshem me “Gjeometer”, gjeometri ne kuptim tjetër parashef mos kufizim te veprimeve dhe matjeve gjeodezike te percaktuara edhe tek objekti i kesaje kontrate gjegjesisht specifikacionet teknike te detyrueshme.

Te gjitha këto veprime ligjerisht mund t'i realizoi vetëm gjeodeti i licencuar dhe jo tekniku gjeometer, pasi qe ne projektin e publikuar nga KRU Gjakova sha, për këtë procedure te prokurimit, janë te percaktuara kushtet e pergjithshme te punes, si brezi i punes gjegjesisht është obligative qe Pune kryesi ti realizoj **Shenimet e trasese.**



Shënimet e trases

Punëkryerësi do të kryej të gjitha inçizimet gjeodezike dhe është i detyruar që të mirëmbajë shenjat e përhershme, reperët e tjera. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet shenjëzimi detal i trasesë dhe i njëjti të përdoret për plotësimin e dokumentacionit teknik në fund të punimeve. Per çdo ndryshim te trases (per shkaqe te ndryshme-probleme pronesore apo te tjera) kontraktori duhet ta bëjë fare në fund projektin në bazë të punëve të kryera.

Këto veprime dhe incizime gjeodezike ligjerisht janë te ndaluara te realizohen nga teknik i gjeodezisë, te njejtat janë te realizueshme vetëm nga Gjeodeti i licencuar.

- Shiqo rregullat ligjore te UA.nr.13/2019, te plotesuar dhe ndryshuar.

Pretendimi ankimore 3

Qeshtja e teknikut te gjeodezisë edhe ne proces te vlerësimit te ofertave është trajtuar nga AK – KRU Gjakova sha, ku është kekruar qe te prezantohet diploma, si rrjedhoje e kerkeses nga grupi i OE-ve te propozuar është prezantuar diploma e shkolles se mesme teknike dhe kualifikimi “Teknik i Gjeodezisë”, perderisa ne dosje te tenderit është kerkuar te prezantohet me “Gjeometer”, ne cilesi te stafit kyc, apo staf profesional. I njejt i nuk mund te jete dhe nuk është dashur te trajtohet si i tille, si rrjedhoje kulifikimi i ofertës se tille si te pergjegjeshme shkele parimet bazike te prokurimit publik, siç është favorizimi gjegjesisht diskriminimi. Për me tepër komisioni vleresues i ofertave me propozim për dhenie te kontratës se ofertës se tille dhe kompanisë se pa pergjegjeshme ka shkelur edhe dispozitat e nenint 59, te LPP-se, ku paragrafi 4, kjarte përcakton qe:


“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..”

Te gjitha këto veprime tregojn për shkelje ligjore, te nenit 6, 7, 51, 59 dhe 69 te LPP-se si rrjedhoje e veprimeve dhe mos veprimeve është shkelur edhe neni 97, i Rregullores, me nr. 001/2022, ku favorizimi dhe diskriminimi konsiderohen si shkelje te renda te LPP-se.

Si perfundim ne si Operator Ekonomik ankues, bazuar ne prova dhe dëshmi, perkatesisht faktet e prezantuara si me sipër, kerkojmë nga OSHP, ti ndermerr veprimet ligjore, qe nga autorizimi i ekespertit perkates njohës te fushës, te pa aneshem dhe i cili sipas nenin 113 te LPP-se i trajton pretendimet tona ankimore ne mënyrë te drejte dhe me pas Paneli Shqyrtues te nxjerr këtë:

V E N D I M

- **Te aprovohet** ne tërësi ankesa e OE Bajram Gashi BI, si e bazuar
- **Te anulohet** njoftimi mbi vendimin e datës 03.12.2024, si i kunderligjegjeshem dhe lënda te kthehet ne **ri vlerësim**
- **Te lejohet** kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses .



Për këto qeshtjes ekzistojne vendime paraprake te OSHP-se te publikuara ne ueb faqen e sajë dhe ne si kompani kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues konsistence si ne procedurat paraprake, ne te kundërtën ne obligohemi qe te inicojme dhe ti raportojmë shkeljet ligjore te zyrtareve pergjigjejs.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme por deri me tani te pa kalkuluar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

